

F.SH.S.U.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E AKTIVITETEVE	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5-17

F.SH.S.U*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2023**

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	421,118	3,188,373
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	2,030,501	575,500
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	2,605	2,605
Total Aktive Afatshkurtra		2,454,224	3,766,478
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	722,754	529,355
Total aktive afatgjata		722,754	529,355
Total aktive		3,176,978	4,295,833
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	8	1,222,317	3,345,070
Detyrime tatimore	9	101,429	7,255
Të ardhurat e shtyra	10	987,778	691,704
Të tjera detyrime	11	865,454	251,804
Total detyrime afatshkurtra		3,176,978	4,295,833
Detyrime afatgjata			
Total detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		3,176,978	4,295,833
Kapitali			
Total kapitali aksionar		-	-
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,176,978	4,295,833

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

F.SH.S.U*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Aktiviteteve
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	12	46,674,441	16,341,896
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	13	(1,336,927)	(25,486)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(44,070,674)	(15,466,860)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	14	(37,456,107)	(12,957,400)
2) Të tjera shpenzime	15	(6,614,567)	(2,509,460)
Shpenzime të personelit	16	(1,111,602)	(656,401)
1) Paga dhe shpërblime		(943,809)	(502,107)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(167,793)	(154,294)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7	(151,601)	(133,860)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	17	(3,637)	(59,558)
Të ardhura të tjera		-	-
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
Shpenzime financiare		-	269
2) Shpenzime të tjera financiare		-	269
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		-	-

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31.12.2023 u firmosën si më poshtë:

Besnik VELIU

F.SH.S.U

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

Shënime	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	-	-
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	1,336,927	25,217
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	151,601	133,860
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(1,455,001)	28,704
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(1,166,355)	2,799,228
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	47,500	(78,861)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(1,085,328)	2,908,148
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(345,000)	(40,000)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(345,000)	(40,000)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(1,430,328)	2,868,148
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	3,188,373	345,442
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(1,336,927)	(25,217)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 421,118	3,188,373

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria " F.SH.S.U" është regjistruar më 21 dhjetor 2017 pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është zhvillimi i aktiviteteve sportive universitare.

Presidenti i Federatës është Z. Besnik Veliu.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L81323451B. Selia qendrore e saj është në Sheshi Nënë Tereza, pranë Rektoratit të Universitetit të Tiranës, Tiranë.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2023 ishte 1 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK për OJF) dhe ligjin nr 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2023 është detajuar si më poshtë:

<u>Kursi i këmbimit</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Euro/LEK	103.88	114.23
USD/ LEK	93.94	107.05

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet të tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2023 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata material (vazhdim)***iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdo rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2023 është 0%.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në bankë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Mjete monetare në bankë	421,118	3,188,373
	<u>421,118</u>	<u>3,188,373</u>

5. Llogaritë e arkëtueshme tregtare afatshkurtra

Llogaritë e arkëtueshme tregtare aftashkurtra më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Klientë vendas	2,030,501	575,500
	<u>2,030,501</u>	<u>575,500</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogaritë të arkëtueshme më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Tatim Fitimi	1,605	1,605
Të arkëtueshme nga Besjan Prekolaj	1,000	1,000
	<u>2,605</u>	<u>2,605</u>

7. Aktive Afatgjata Materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Të tjera	Totali
Kosto				
Gjendja më 31 dhjetor 2021	642,249	110,000	0	752,249
Shtesa			40,000	40,000
Gjendja më 31 dhjetor 2022	642,249	110,000	40,000	792,249
Shtesa	-	334,000	11,000	345,000
Gjendja më 31 dhjetor 2023	642,249	444,000	51,000	1,137,249
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2021	-99,300	-29,734	-	-129,034
Amortizimi i vitit	-108,440	-20,253	-5,167	-133,860
Gjendja më 31 dhjetor 2022	-207,740	-49,987	-5,167	-262,894
Amortizimi i vitit	-86,752	-57,149	-7,700	-151,601
Gjendja më 31 dhjetor 2023	-294,492	-107,136	-12,867	-414,495
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2021	542,949	80,266	-	623,215
Gjendja më 31 dhjetor 2022	434,509	60,013	34,833	529,355
Gjendja më 31 dhjetor 2023	347,757	336,864	38,133	722,754

8. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Furnitorë	1,222,317	3,345,070
	<u>1,222,317</u>	<u>3,345,070</u>

9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	18,620	9,481
Tatim në Burim	82,809	(2,226)
	<u>101,429</u>	<u>7,255</u>

10. Të ardhura të shtyra

Të ardhura të shtyra më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Te ardhura te periudhave te ardheshme antaresime	687,778	475,657
Te ardhura te periudhave te ardheshme UNDP	-	216,047
Te ardhura te periudhave te ardhshme Shoqata Kongresi Rinor Kombetar	300,000	-
	<u>987,778</u>	<u>691,704</u>

11. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Pagat e punonjësve	48,090	590
Pagesa per individ me kontrate sherbimi	630,250	81,100
Financime Besnik Veliu	17,000	-
Financim nga European Education Initiative	170,114	170,114
	<u>865,454</u>	<u>251,804</u>

12. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022</u>
Te ardhura nga antaresimi	1,976,337	2,575,000
Te ardhura nga projekte brenda vendit	10,695,347	7,289,203
Te ardhura nga taksa pjesmarrje ne akt nderk	29,515,345	254,688
Te ardhura nga sponsorizimi	430,458	623,007
Te ardhura nga projekte jashte vendit	1,056,954	-
Te ardhura nga granti M. Sportit	3,000,000	5,599,998
	<u>46,674,441</u>	<u>16,341,896</u>

13. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhura të tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022</u>
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(1,336,927)	(25,486)
	<u>(1,336,927)</u>	<u>(25,486)</u>

14. Shpenzime per aktivitetet kryesore

Shpenzime per aktivitetet kryesore më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022
Sherbime arbitrimi	2,195,594	685,588
Sherbime transporti	4,507,577	854,000
Sherbim qera mbjentesh sportive	1,228,500	542,600
Sherbim akomodimi per kampionate	11,906,468	1,619,161
Sherbim restoranti per kampionate	3,969,722	492,602
Sherbime mjekesore	500,592	183,589
Materiale konsumi per kampionatin	1,773,886	918,250
Shpenzime dietash	195,118	135,000
Shpenzime per uniforma sportive	3,564,800	3,990,001
Shpenzime per pjesmarrje ne aktivitete nderkombetare	1,309,296	2,742,271
Sherbime koordinimi dhe menaxhimi	3,869,793	594,338
Sherbim katering	452,500	200,000
Materiale konsumi per kampionatin te panjohura	18,300	-
Materiale mjekesore per kampionatin	90,729	-
Sherbime performimi dhe kercimi	315,232	-
Sherbime skenografie	632,000	-
Shpenzime per blerje topa te ndryshem	926,000	-
	37,456,107	12,957,400

15. Të tjera shpenzime

Të tjera shpenzime më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022</u>
Karburant	216,097	109,570
Sherbime grafike	-	60,000
Shpenzime per promovimin e aktivitetit	852,001	429,501
Sherbime audio	220,000	50,000
Sherbime Web	41,732	-
Sherbim interneti	55,590	23,880
Shpenzime bankare	91,437	70,634
Taksa dhe tarifa vendore	30,000	15,000
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	1,779,884	215,821
Sherbime financiare	477,275	286,000
Sherbime ligjore	79,400	33,000
Sherbime administrative	8,416	21,928
Shpenzime per honorare	110,000	341,126
Shpenzime udhetimesh	718,694	466,350
Kancelari	38,953	165,000
Sherbime fotografike	306,472	112,000
Dieta per jashte vendit	24,335	109,650
Shpenzime per blerje inventar i imet	4,500	-
Sherbime marketingu	1,559,781	-
	<u>6,614,567</u>	<u>2,509,460</u>

16. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>
Shpenzime për paga	943,809	502,107
Shpenzime për sigurime shoq e shëndetësore	167,793	154,294
	<u>1,111,602</u>	<u>656,401</u>

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2023 ishte 1 punonjës.

17. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>
Gjopa dhe dëmshpërblime	3,637	59,558
	<u>3,637</u>	<u>59,558</u>

18. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2023 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

19. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.